




Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Shërbimeve Publike - Ministarstva Javnih Sluzbi - Ministry of Public Services*

## Seria 5: Statistikat Sociale

# Statistikat e standardit jetësor 2007



Enti i Statistikës së Kosovës  
Zavod za Statistiku Kosova  
Statistical Office of Kosovo






Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Shërbimeve Publike - Ministarstva Javnih Sluzbi - Ministry of Public Services*

## Seria 5: Statistikat Sociale

# Statistikat e standardit jetësor 2007



Enti i Statistikës së Kosovës  
Zavod za Statistiku Kosova  
Statistical Office of Kosovo

Botuesi: Enti i Statistikës së Kosovës (ESK)

Data e botimit: Nëntor 2008

© : Enti i Statistikës së Kosovës

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

E shtypur nga: K.G.T, Prishtinë, Kosovë

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,  
ku mund të qasenë përmes veb-faqes së ESK-së  
në internet: [www.ks-gov.net/esk](http://www.ks-gov.net/esk)

## Parathënie

Qëllimi i publikimit të Statistikave të standardit jetësor është që të ofrojmë të dhëna statistikore lidhur me standardin jetësor në Kosovë, kryesisht lidhur me buxhetin e ekonomive familjare.

Në këtë publikim janë përmbledhur të dhëna për konsumin, shpenzimet dhe të ardhurat e ekonomive familjare për periudhat 2003 - 2007. Për grumbullimin e të dhënave, Enti Statistikor i Kosovës (ESK) ka përdorur Anketën mbi Buxhetin e Ekonomisë Familjare (ABEF).

Përmes këtij publikimi është synuar zbutja e mungesës së informacioneve në fushën e standardit jetësor në Kosovë. Besojmë se ky publikim do të shërbejë si bazë e dobishme referuese për të gjithë shfrytëzuesit e të dhënave statistikore.

Ftojme të gjithë shfrytëzuesit e këtij publikimi për bashkëpunim. Komentet dhe propozimet tuaja mund të na i përcjellin në email adresën: [social@ks-gov.net](mailto:social@ks-gov.net), me çka do të kontribuoni në ngritjen e kualitetit të publikimeve në të ardhmen.

Në përgatitjen e këtij publikimi kanë kontribuar punonjësit e sektorit të Statistikave të standardit jetësor:

1. Mr. Sc. Bashkim BELLAQA – Drejtor i Departamentit të Statistikave Sociale,
2. Emine DELIU – Shefe e Sektorit të Standardit Jetësor,
3. Bekim CANOLLI – Shef i Divizionit të Metodologjisë,
4. Besa HAQIFI – Zyrtare e lartë e Sektorit të Standardit Jetësor,
5. Hatixhe JANUZAJ - Zyrtare e Sektorit të Standardit Jetësor,
6. Mevlyde DEHARI - Zyrtare e Sektorit të Standardit Jetësor dhe
7. Dizajni: Ahmet ÇAKOLLI.

Përkrahje profesionale për zhvillimin e ABEF, kanë ofruar Organizata Suedeze SIDA dhe Banka Botërore (BB). Për mbështetje profesionale të këtij publikimi veçanërisht falënderojmë ekspertët e organizatës Suedeze SIDA z. Lars Lundgren dhe z. Claes Andersson si dhe ekspertet nga Banka Botërore z. Andrew Dabalén dhe z-nja Anna Gueorgueva.

Falënderojmë punëtorët e zyrave rajonale të ESK-së, për anketimin e ekonomive familjare.

Nëntor, 2008

Kryeshefi Ekzekutiv i ESK-së,  
Avni Kastrati

## Lista e shkurtesave

ABEF	Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare
SIDA	Agjencioni Ndërkombëtar për Zhvillim dhe Bashkëpunim
BB	Banka Botërore
ESK	Enti i Statistikës së Kosovës
IÇK	Indeksi i Çmimeve Konsumuese
LLK	Llogaritë Kombëtare
BE	Bashkimi Evropian
KKIQ	Klasifikimi i konsumit individual sipas qëllimit

## Përmbajtja

	Faqe
HYRJE .....	5
1 Konsumi i ekonomive familjare në Kosovë 2003 – 2007 .....	6
1.1. Konsumi i përgjithshëm .....	7
1.2. Ushqimi .....	8
1.3. Banimi .....	9
1.4. Rrobat dhe veshmbathjet .....	10
1.5. Transporti .....	10
1.6. Mobiliet .....	11
1.7. Konsumi kryesor .....	11
1.8. Alkooli dhe duhani .....	12
1.9. Shëndetësia .....	13
1.10. Komunikimi .....	13
1.11. Rekreacioni .....	14
1.12. Arsimi .....	14
1.13. Hotele dhe restorante .....	15
1.14. Mallrat të tjera .....	15
1.15. Konkluzion .....	16
2 Konsumi i përgjithshëm në Kosovë 2003 - 2007 .....	18
2.1. Trendët e konsumit .....	18
2.2. Shpërndarja e konsumit .....	19
3 Të hyrat private në Kosovë 2003 - 2007 .....	21
3.1. Të hyrat kryesore të ekonomive familjare .....	21
3.2. Burimet e të hyrave individuale .....	22
3.3. Pabarazia gjinore .....	23





## HYRJE

Enti i Statistikës së Kosovës (ESK) mat në mënyrë të vazhdueshme konsumin privat nëpërmjet ABEF.

Këto statistika janë të nevojshme për të përcaktuar shportën për Indeksin e Çmimeve Konsumuese (IÇK), konsumin privat në Llogaritë Kombëtare (LLK) dhe analizimin e mirëqenies dhe varfërisë. Anketa gjithashtu mat edhe arsimimin, punësimin, kushtet e banimit, pronësinë e mallrave të qëndrueshme, ndërtimin dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me bizneset dhe kultivimin e tokës.

Të dhënat janë mbledhur në tërë Kosovën gjatë një viti duke përfshirë 2 400 ekonomi familjare në vit të zgjedhura sipas rastit dhe në pajtim me standardet e bashkimit Evropian (BE) dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Shkalla e përgjigjeve është më e lartë se 80 % nëse ekonomitë familjare të zëvendësuara janë konsideruar se nuk kanë dhënë përgjigje.

Progresi ekonomik në vitet e fundit do të definohej si përmirësim i kushteve të jetesës në krahasim me periudhën menjëherë pas luftës. Në këto rrethana, ABEF është e mirëseardhur për matjen e standardit jetësor, për matjen e Bruto Produktit Kombëtar (BPK) si dhe fitimin e ponderave të çmimeve konsumuese.

Mostra ka shtrirje në zonat urbane dhe rurale, në tërë territorin e Kosovës. Përpunimi dhe analizimi i të dhënave është bërë përmes programeve ACCESS dhe SPSS. Pyetësi përmbante informata mbi përbërjen demografike të ekonomisë familjare duke përfshirë të dhëna individuale mbi secilin anëtar të ekonomisë familjare, si dhe të ardhurat, konsumin dhe shpenzimet, kushtet e banimit, aktivitete në biznese dhe bujqësi, qasjen në infrastrukturën themelore dhe në shërbimet publike.

Mbledhja e të dhënave nga ekonomitë familjare është bërë nga ana e punëtorëve të zyrave rajonale ESK-ës.

## 1 Konsumi i ekonomive familjare në Kosovë 2003 – 2007

Konsumi është pjesë e rëndësishme e jetës së njerëzve. Pasuria dhe varfëria varen nga aspektet tjera në jetë, por niveli i konsumit dhe përmasat e tij janë qenësore për mirëqenien.

Përderisa të hyrat fitohen nga individët, konsumi kryesisht ka të bëjë me ekonomitë familjare. Alkooli dhe duhani, veshmbathjet, rekreacioni dhe disa gjëra tjera specifike mund të konsumohen individualisht, por pjesa më e madhe, si ushqimi, banimi dhe furnizimi shfrytëzohen së bashku nga pjesëtarët e ekonomive familjare.

Konsumi klasifikohet sipas standardit të Klasifikimit të Konsumit Individual sipas Qëllimit (KKIQ) në harmonizim me Llogaritë Kombëtare dhe Indeksin e Çmimeve Konsumuese. Përveç disa përmirësimeve, standarde të njëjta janë aplikuar gjatë viteve, duke e bërë atë të krahasueshëm më lehtë gjatë kohës.

Shumica e konsumit bazohet në mallrat e blera dhe shërbimet e paguara gjatë periudhës së referuar. Periudha e referuar është një muaj për konsumin ditor (të mbështetur me mbajtjen e shënimeve) dhe 12 muajt e fundit për mallrat e qëndrueshme.

Duke ju përmbajtur rekomandimeve ndërkombëtare, shpenzimet aktuale për banim nuk janë mbledhur, por vetëm qiraja e vlerësuar e bazuar në vlerësimin e vetë ekonomisë familjare.

Në këtë dokument ne do të fokusohemi në nivelin e konsumit për grupe të ndryshme konsumuese (ushqim, veshmbathje, banim, etj.) dhe pjesëmarrjen e tyre në konsumin e përgjithshëm. Ne gjithashtu do t'i krahasojmë disa grupe të ekonomive familjare.

Ekonomitë familjare me arsim të lartë dhe ekonomitë familjare urbane mund të shihen si treguese për zhvillimin e ardhshëm të konsumit, pasi që gjithnjë e më shumë njerëzit po arsimohen dhe Kosova është duke u urbanizuar.

Shifrat në tekst janë rrumbullakësuar që të sinjalizojnë se një mostër anketë mund t'i japë vetëm vlerat e përafërta.

## 1.1. Konsumi i përgjithshëm

Konsumi për ekonomi familjare gjatë vitit 2007 në Kosovë ka qenë 5 700 €.


Gjatë vitit 2007 ekonomitë familjare urbane kanë pasur një konsum më të lartë 6 144 €, ndërsa konsumi në ekonomitë familjare rurale ka qenë 5 436 €.

Sipas rezultateve të dala të ABEF, për vitin 2007, konsumi i përgjithshëm është rritur te ekonomitë familjare që kanë arsimim më të lartë.

Ekonomitë familjare me kryefamiljarët që kanë përfunduar vetëm arsimin fillore apo më pak, konsumojnë rreth 5 380 €, ndërsa ato më arsimim të mesëm konsumojnë 5 718 € si dhe ato me arsim të lartë 7 472 €.

Ekonomitë familjare rurale dhe më pak të arsimuara kanë pasur nivel më të ulët të konsumit dhe më shumë pjesëtarë për ta ndarë atë.

**Figura 1: Konsumi i përgjithshëm vjetor i ekonomive familjare sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2007**




## 1.2. Ushqimi


Pjesa më e madhe e buxhetit shfrytëzohet për ushqim dhe është llogaritur 2 280 € për vitin 2007 apo 40 % të konsumit të përgjithshëm, që paraqet zvogëlim krahasuar me vitin 2003 ku konsumi i ushqimit ka qenë 47 %.

Pjesa më e vogël e buxhetit e shpenzuar për ushqim tregon një mirëqenie më të lartë. Pjesa për ushqim ka qenë ndërmjet 10% dhe 19% në shtetet anëtare të EU në vitin 1999.

**Figura 2: Konsumi vjetor i ushqimit nga ekonomitë familjare sipas lokalitetit dhe nivelit arsimit 2003-2007 në €**



**Figura 3: Pjesëmarrja e ushqimit në konsumin e përgjithshëm sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2007 në %**



### 1.3. Banimi


Banimi përbën pjesën e dytë më të madhe të buxhetit të ekonomive familjare me 1 830 € apo 32 % të buxhetit të ekonomive familjare.

Ushqimi dhe banimi së bashku përbëjnë më shumë se dy të tretat apo 72 % të buxhetit të ekonomive familjare.

Pjesa më e madhe e banimit është “qiraja e vlerësuar”. Një pjesë e vogël e ekonomive familjare paguajnë qira.

Pjesa e buxhetit e cila është ndarë për banim sillet nga 28 % për ekonomitë familjare rurale, deri 37 % për ato urbane. Në vitin 1999 banimi në shtetet anëtare të BE-së ka qenë nga 20 - 31 %.


**Figura 4: Shpenzimet për banim të ekonomive familjare sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2007 në €**



### 1.4. Rrobat dhe veshmbathjet

Një ekonomi familjare mesatarisht shpenzon rreth 300 € në vit për rroba dhe veshmbathje apo 5 % të buxhetit. Pjesa e buxhetit që ndahet për rroba sillet prej 5 – 6 %, krahasuar me 5 – 9 % brenda BE-së në 1999.


**Figura 5: Shpenzimet për rroba dhe veshmbathje të ekonomive familjare sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2007 në €**



### 1.5. Transporti

Transporti ka pasur ngritje gjatë viteve 2003, 2004 dhe 2005, por një rënie e vogël në vitin 2006 dhe 2007. Pjesa e buxhetit të ndarë për transporte në vitin 2007 ka qenë 4 % për ekonomitë familjare urbane ndërsa 6 % për ato rurale. Ekonomitë familjare me arsimim të lartë shfrytëzojnë 5 % të buxhetit të tyre në transporte. Në BE në vitin 1999 pjesa e buxhetit për transporte ka qenë ndërmjet 10 e 17 %.

**Figura 6: Shpenzimet e transportit të ekonomive familjare sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2007 në €**




## 1.6. Mobiliet

Prej vitit 2005 deri 2007 është evidente një rënie e shpenzimeve për mobilie. Një ekonomi familjare gjatë vitit 2007 mesatarisht ka shpenzuar rreth 200 € në vit, ndërsa ato me arsim të lartë mesatarisht kanë shpenzuar 228 € në vit.

Pjesa e buxhetit të ndarë për mobilie ishte rreth 4 % në vitin 2007, ndërsa në vendet e BE ishte 5 - 8 % në vitin 1999.


**Figura 7: Mobiliet sipas lokalitetit dhe nivelit arsimit 2003-2007 në €**



## 1.7. Konsumi kryesor

Pesë kategoritë kryesore të konsumit më të lartë (ushqimi, banimi, rrobat dhe veshmbathjet, transporti dhe mobiliet) paraqesin 86 % të konsumit të përgjithshëm. Shtatë grupet tjera të konsumit kanë pasur përqindje më të vogël.


**Figura 8: Pesë kategoritë kryesore të konsumit të ekonomive familjare sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit, % e përgjithshme**



## 1.8 . Alkooli dhe duhani

Në buxhetin e përgjithshëm të ekonomisë familjare alkooli dhe duhani marrin pjesë me 4 % apo 220 €. Ky konsum është rritur në vitin 2005 dhe 2006. Në BE ky konsum sillet ndërmjet 2 deri në 7 %.

**Figura 9: Konsumi i Alkoolit dhe duhanit të ekonomive familjare sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2007, në €**



**Tabela 1: Përqindja e duhanxhinjve në popullatë në vitin 2007 sipas gjinisë dhe konsumit ditor të cigareve , % e popullatës në moshën 16 vjet dhe më të moshuar**

	Meshkujt		Femrat		Të gjithë	
	2006	2007	2006	2007	2006	2007
1 deri 10	2	2	1	2	1,5	2
11deri 20	20	21	3	4	11,5	12
21 +	5	4	0	0	2,5	2
Nr. përgj. i duhanxhinjve	27	27	4	6	15,5	16




### 1.9. Shëndetësia

Shpenzimet për shëndetësi janë rritur mjaftë shumë në vitin 2007, prej 145 € krahasuar me vitin 2006 që ishin 119 €.

Ekonomitë familjare me arsimim të lartë në vitin 2006 kanë shpenzuar më shumë për shëndetësi se sa ato me nivel më të ulët të arsimit, ndërsa në vitin 2007 për shëndetësi kanë shpenzuar më shumë familje me arsim fillor.


**Figura 10: Shpenzimet për shëndetësi të ekonomive familjare sipas lokalitetit dhe nivelit arsimit 2003-2007, në €**



### 1.10. Komunikimi

Shpenzimet për komunikim gjithashtu janë rritur shumë gjatë viteve 2004, 2005 dhe 2006 ku janë rritur deri 129 €, por në vitin 2007 vërehet një rënie (111 €). Ekonomitë familjare urbane dhe ato me shkollim të lartë shpenzojnë më shumë për komunikim.


**Figura 11: Shpenzimet e komunikimit të ekonomive familjare sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2007, në €**



### 1.11. Rekreacioni

Niveli i shpenzimeve për të gjitha ekonomitë familjare ka qenë më i lartë në vitin 2004. Në vitin 2006 ekonomitë familjare urbane kanë shpenzuar më tepër për rekreacion (82 €) në krahasim me vitin 2007 (77 €).


**Figura 12: Shpenzimet për rekreacion sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2007, në €**



### 1.12. Arsimi

Edhe shpenzimet për arsim gjithashtu kanë qenë më të larta në vitin 2004, sidomos ekonomitë familjare me arsimim të lartë. Në vitin 2006, në krahasim me vitin 2007 ka rënie të shpenzimeve për arsim prej 45 € në 36 €.


**Figura 13: Shpenzimet për arsim të ekonomive familjare sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2007, në €**



### 1.13. Hotele dhe restorante

Shpenzimet për hotele dhe restorante gjatë viteve 2003-2006 kanë pasur rritje si gjatë kohës ashtu edhe ndërmjet grupeve. Në vitin 2007, shpenzimet për hotele dhe restorante janë zvogëluar në krahasim me shpenzimet e vitit 2006, përveç shpenzimeve në vise urbane që kanë shënuar një rritje të dukshme..


**Figura 14: Shpenzimet për hotele dhe restorante të ekonomive familjare sipas lokalitetit dhe nivelit arsimit 2003-2007, në €**



### 1.14. Mallrat të tjera

Ky grup është një përzierje e mallrave për rregullim të flokëve, mallrave për nevoja personale, shpenzime për sigurime dhe shpenzime tjera financiare. Ekonomitë familjare kanë pasur ngritje të vazhdueshme deri në vitin 2006, por edhe në vitin 2007 në ekonomitë familjare urbane . Nëpër grupet tjera në vitin 2007 vërehet një rënie e shpenzimeve për mallra tjera.

**Figura 15: Shpenzimet tjera të ekonomive familjare sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2003-2007, në €**



## 1.15. Konkluzion

Ekonomia familjare kosovare ngadalë po transformohet nga dominimi i ushqimit në banim, veshmbathje dhe transport. Ekonomitë familjare urbane dhe ato me arsim të lartë janë më përpara në këtë aspekt dhe po e rrisin pjesën e buxhetit për komunikacion, arsim, rekreacion, hotele e restorante.

**Tabela 2: Konsumi vjetor i ekonomive familjare në Kosovë 2003-2007 sipas grupeve kryesore të konsumit, lokalitetit dhe arsimit të kryefamiljarëve të ekonomive familjare, € dhe % konsumit të përgjithshëm**

Vitet	Ushqimi	Alko & duhan	Veshmb.	Banim	Mobilie	Shënd.	Transp.	Komun.	Rekr.	Arsim	Hotel & rest	Te tjera	Totali €
2003	2 484 €	178	257	1 536 €	211	79	223	69	62	37	53	91	5 281 €
2004	2 320 €	176	307	1 806 €	128	122	274	91	77	82	64	116	5 563 €
2005	2 274 €	229	337	1 834 €	237	133	353	123	70	42	70	162	5 863 €
2006	2 222 €	220	317	1 779 €	219	119	327	129	74	45	113	157	5 721 €
2007	2 282 €	206	296	1 833 €	210	145	285	111	69	36	103	145	5 721 €
Urbane													
2003	2 249 €	189	233	2 060 €	219	77	189	122	78	20	78	107	5 621 €
2004	2 246 €	174	285	2 254 €	123	107	235	134	89	96	91	112	5 946 €
2005	2 121 €	216	354	2 384 €	225	128	341	162	120	57	104	186	6 399 €
2006	2 241 €	224	228	2 227 €	209	108	291	176	82	42	102	158	6 088 €
2007	2 144 €	210	281	2 286 €	198	136	262	147	77	29	171	173	6 144 €
Rurale													
2003	2 605 €	173	270	1 268 €	207	79	241	42	54	46	40	83	5 107 €
2004	2 366 €	177	320	1 528 €	131	132	298	65	70	73	47	119	5 326 €
2005	2 378 €	237	325	1 463 €	245	136	361	96	36	32	48	147	5 503 €
2006	2 211 €	230	327	1 532 €	225	125	347	102	69	46	98	157	5 469 €
2007	2 384 €	202	307	1 503 €	219	152	303	85	63	40	53	125	5 436 €
Arsim fillor													
2003	2 454 €	185	235	1 323 €	198	85	207	48	49	32	28	83	4 927 €
2004	2 220 €	186	265	1 480 €	90	132	221	65	46	47	34	91	4 877 €
2005	2 274 €	243	277	1 506 €	216	134	301	99	22	33	44	151	5 300 €
2006	2 186 €	262	332	1 635 €	222	131	319	110	67	35	78	166	5 543 €
2007	2 199 €	207	283	1 695 €	226	155	233	89	58	43	52	140	5 380 €
Arsim të mesëm													
2003	2 451 €	168	254	1 576 €	207	74	214	71	66	38	44	90	5 252 €
2004	2 310 €	164	301	1 913 €	146	108	276	95	66	81	59	120	5 637 €
2005	2 210 €	221	328	1 858 €	235	122	335	124	74	42	66	151	5 766 €
2006	2 197 €	215	322	1 826 €	212	97	331	134	77	44	139	151	5 745 €
2007	2 297 €	210	301	1 835 €	199	133	294	112	63	27	109	138	5 718 €
Arsim të lartë													
2003	2 669 €	184	345	2 176 €	271	68	310	136	102	54	164	127	6 605 €
2004	2 695 €	175	469	2 621 €	208	133	454	169	221	208	181	192	7 728 €
2005	2 437 €	209	530	2 693 €	300	159	541	187	191	66	156	222	7 692 €
2006	2 332 €	170	454	2 556 €	275	149	505	226	170	109	339	270	7 555 €
2007	2 542 €	160	373	2 730 €	228	135	395	192	123	58	314	222	7 472 €

**Tabela 2: Konsumi vjetor i ekonomive familjare në Kosovë 2003-2007 sipas grupeve kryesore të konsumit, lokalitetit dhe arsimit të kryefamiljarëve të ekonomive familjare, € dhe % konsumit të përgjithshëm (vazhdim)**

Vitet	Ushqimi	Alko & duhan	Veshmb	Banim	Mobilie	Shënd	Transp	Komu	Rekre	Arsim	Hotel & rest	Te tjera	Totali % <sup>†</sup>
2003	47%	3%	5%	29%	4%	1%	4%	1%	1%	1%	1%	2%	89%
2004	42%	3%	6%	32%	2%	2%	5%	2%	1%	1%	1%	2%	87%
2005	39%	4%	6%	31%	4%	2%	6%	2%	1%	1%	1%	3%	86%
2006	39%	4%	6%	31%	4%	2%	6%	2%	1%	1%	2%	3%	86%
2007	40%	4%	5%	32%	4%	3%	5%	2%	1%	1%	2%	3%	86%
<b>Urbane</b>													
2003	40%	3%	4%	37%	4%	1%	3%	2%	1%	0%	1%	2%	88%
2004	38%	3%	5%	38%	2%	2%	4%	2%	1%	2%	2%	2%	86%
2005	33%	3%	6%	37%	4%	2%	5%	3%	2%	1%	2%	3%	85%
2006	37%	4%	4%	37%	3%	2%	5%	3%	1%	1%	2%	3%	86%
2007	35%	3%	5%	37%	3%	2%	4%	2%	1%	0%	3%	3%	84%
<b>Rural</b>													
2003	51%	3%	5%	25%	4%	2%	5%	1%	1%	1%	1%	2%	90%
2004	44%	3%	6%	29%	2%	2%	6%	1%	1%	1%	1%	2%	87%
2005	43%	4%	6%	27%	4%	2%	7%	2%	1%	1%	1%	3%	87%
2006	40%	4%	6%	28%	4%	2%	6%	2%	1%	1%	2%	3%	84%
2007	44%	4%	6%	28%	4%	3%	6%	2%	1%	1%	1%	2%	88%
<b>Arsim fillor apo më pak</b>													
2003	50%	4%	5%	27%	4%	2%	4%	1%	1%	1%	1%	2%	90%
2004	46%	4%	5%	30%	2%	3%	5%	1%	1%	1%	1%	2%	88%
2005	43%	5%	5%	28%	4%	3%	6%	2%	0%	1%	1%	3%	86%
2006	39%	5%	6%	29%	4%	2%	6%	2%	1%	1%	1%	3%	84%
2007	41%	9%	5%	32%	4%	3%	4%	2%	1%	1%	1%	3%	86%
<b>Arsim të mesëm</b>													
2003	47%	3%	5%	30%	4%	1%	4%	1%	1%	1%	1%	2%	90%
2004	41%	3%	5%	34%	3%	2%	5%	2%	1%	1%	1%	2%	88%
2005	38%	4%	6%	32%	4%	2%	6%	2%	1%	1%	1%	3%	86%
2006	38%	4%	6%	32%	4%	2%	6%	2%	1%	1%	2%	2%	86%
2007	40%	4%	5%	32%	3%	2%	5%	2%	1%	0%	2%	2%	85%
<b>Arsim të lartë</b>													
2003	40%	3%	5%	33%	4%	1%	5%	2%	2%	1%	2%	2%	87%
2004	35%	2%	6%	34%	3%	2%	6%	2%	3%	3%	2%	2%	83%
2005	32%	3%	7%	35%	4%	2%	7%	2%	2%	1%	2%	3%	85%
2006	31%	2%	6%	34%	4%	2%	7%	3%	2%	1%	4%	4%	82%
2007	34%	2%	5%	37%	3%	2%	5%	3%	2%	1%	4%	3%	84%

<sup>†</sup> Këtu janë përfshirë pesë grupet kryesore të konsumit (ushqimi, banimi, rrobat dhe veshmbathjet, transporti, mobilie).

## 2 Konsumi i përgjithshëm në Kosovë 2003 - 2007

Ky publikim paraqet të dhënat makroekonomike nga ABEF për vitin 2003 - 2007.

Në disa raste rezultatet ndryshojnë nga Llogaritë Kombëtare (LLK-të), pasi që LLK-të plotësohen më disa burime tjera të të dhënave ( si p.sh të dhëna prej doganave, të dhëna nga importi dhe të dhëna tjera nga prodhimi vendor) dhe bëjnë disa përshtatje.

Të dhënat janë grumbulluar sipas standardit ndërkombëtar të Klasifikimit të Konsumit Individual sipas Qëllimit (KKIQ). Më një mostër paksa më të vogël rezultatet duhet të konsiderohen si të përafërta. Pa një regjistrim të ri të përgjithshëm të popullsisë është vështirë që të bëhet ndonjë vlerësim.

### 2.1. Trendët e konsumit

**Tabela 1: Totali i konsumit privat në Kosovë 2003-2007**

Viti	Milion €	Konsumi për ekonomitë familjare €	Konsumi për kokë banori €
2003	1.493	5.400	840
2004	1.529	5.600	910
2005	1.549	5.900	950
2006	1.429	5.700	980
2007	1.413	5.700	980

## 2.2. Shpërndarja e konsumit

Pjesa më e madhe e buxhetit është shpenzuar në ushqim rreth 40 % të konsumit të përgjithshëm. E dyta është banimi me më shumë se 30 % dhe vendin e tretë e zënë transporti dhe veshmbathja me 5 %.

Pjesa për ushqimin është zvogëluar në krahasim me vitin 2003 dhe kjo mund të shihet si një shenjë e një standardi më të lartë ekonomik.

Konsumi i ushqimit në vitin 2003 është paksa mbivlerësuar, për shkak të mënyrës së ndryshme të matjes së ushqimit të prodhuar vendor krahasuar me vitet tjera.

Në vitin 2007 rreth 8% e konsumit të përgjithshëm përfshirë ushqimin nga prodhimi vendor.

**Tabela 4: Shpërndarja e konsumit në Kosovë 2003-2007**

	(%)				
<b>Konsumi</b>	<b>2003</b>	<b>2004</b>	<b>2005</b>	<b>2006</b>	<b>2007</b>
Ushqimi	48	43	40	39	40
Alkohol & Duhan	3	3	4	4	4
Veshmbathja		5	6	5	5
Banimi	29	31	31	31	32
Mobilie	4	3	4	3	4
Shëndetësi	1	2	2	2	3
Transport	4	5	6	6	5
Komunikim	1	2	2	2	2
Rekreacion	1	1	1	1	1
Edukim	1	1	1	1	1
Hotele dhe Restorante	1	1	1	2	2
Të tjera	2	2	3	3	3
<b>Gjithsej</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>
<i>Ushqimi i prodhuar vendor</i>	<i>13</i>	<i>9</i>	<i>9</i>	<i>7</i>	<i>8</i>

**Tabela 5: Shpërndarja e konsumit në BE në vitin 1999**

Konsumi	Min	Maks
Ushqimi	10	19
Alkooli & duhani	2	7
Rrobat	5	9
Banimi	20	31
Mobilie	5	8
Shëndetësia	1	6
Transporti	10	17
Komunikacioni	2	3
Rekreacioni	5	15
Arsim	0	2
Hotele & restorante	4	10
Të tjera	5	15

(%)

Burimi: ABEF 1999, Eurostat

Ushqimi në Kosovë dominohet nga buka, ushqimi nga drithërat, mishi, produktet ditore dhe vezët që kontribuojnë në pothuajse gjysmën e konsumimit të ushqimit (në vlerë). Më pas vinë perimet dhe pijet joalkoolike.

**Tabela 6: Shpërndarja e konsumit të ushqimit në Kosovë 2003-2007**

Konsumi	2003	2004	2005	2006	2007
Buka dhe drithërat	22	21	23	19	20
Mishi	12	13	12	19	19
Peshku	1	1	1	1	1
Produktet ditore, vezët	23	22	21	19	21
Vajrat dhe yndyrat	4	5	4	5	5
Frutat	6	7	7	6	6
Perimet	13	13	12	12	11
Sheqeri dhe ëmbëlsirat	6	5	6	5	5
Produktet e ushqimit	5	5	5	5	4
Pijet jo alkoolike	8	9	9	9	7
Ushqimi i përgjithshëm	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>



### 3 Të hyrat private në Kosovë 2003 - 2007

#### 3.1. Të hyrat kryesore të ekonomive familjare

Rrogat nga sektori publik janë burimi më i rëndësishëm i të hyrave në Kosovë dhe janë burimi kryesor për gati një të tretën e ekonomive familjare.

Burimi tjetër më i rëndësishëm janë rrogat nga sektori privat si dhe të hollat e dërguara nga jashtë.

Pothuajse një nga dhjetë ekonomitë familjare jeton nga paratë e dërguara nga jashtë (remitenca).

Shumica e ekonomive familjare kanë burime të përziera të të hyrave, prandaj të hyrat e tanishme japin një pasqyrë të ndryshme.

**Tabela 7: Burimi kryesor i të hyrave për ekonomitë familjare në Kosovë, % e ekonomive familjare**

Burimi i të hyrave	2007	2006
Rrogat dhe pagat nga sektori publik	27	31
Rrogat dhe pagat nga sektori privat	21	16
Bujqësi	7	6
Të ardhurat nga mëditjet	8	8
Biznese të tjera të ekonomive familjare	8	12
Pensionet	8	7
Të hollat e dërguara nga jashtë	11	10
Të hollat e dërguara-tjera	2	1
Ndihma sociale	6	6
Te tjera	2	1
Totali	100	100

### 3.2. Burimet e të hyrave individuale

Burimi kryesor i të hyrave janë rrogat nga punësimi i rregullt që përbëjnë rreth gjysmën e të hyrave të përgjithshme. Rreth 6 % janë fituar nga puna e përkohshme.

Të hyrat neto nga bizneset e një shkalle më të vogël përbëjnë 10% të të hyrave të përgjithshme dhe nga bujqësia 3 %.

Burimi i dytë më i madhi janë paratë e gatshme të dërguara nga jashtë (remitenca) nga pjesëtarët e ekonomive familjare (9 %) më një shtesë prej 3 % nga të tjerët jashtë vendit. Pensionet nga Kosova përbëjnë 5 % dhe pensionet nga jashtë 5 %.

Femrat fitojnë vetëm 20 % të të hyrave të përgjithshme. Rrogat nga punësimi i rregullt janë më të rëndësishme për femrat sesa për meshkujt.

Pensionet nga Kosova përbëjnë burimin e dytë më të rëndësishëm për femrat me 12 % krahasuar me vetëm 3 % për meshkujt.

Arsimimi ka ndikim kryesor në burimet e të hyrave. Arsimimi më i madh shpie në më shumë të ardhura nga punësimi i rregullt. Ata me shkollë fillore apo më pak, në masë të konsiderueshme duhet të jetojnë nga mëditjet, pensionet nga jashtë, biznesi vetanak dhe mbështetja nga jashtë. Natyrisht ekziston një korrelacion i përafërt ndërmjet arsimimit dhe moshës. Njerëzit më shkollë të mesme sigurojnë 13 % të të hyrave të tyre nga bizneset.

**Tabela 8: Burimet e të hyrave në Kosovë, viti 2007, % e të hyrave**

Burimi i të hyrave	Meshkuj	Femra	Të gjithë
Neto rrogat dhe pagesat e fituara në Kosovë,neto pa tatim	51	61	53
Pagat në natyrë	0	0	0
Të ardhurat nga mëditjet	7	0	6
Qiraja,dividendat,interesi(nga kursimi në bankë)	2	0	2
Benefitet për mirëqenie sociale	2	3	2
Pensionet nga Kosova	3	12	5
Pensionet jashtë Kosovës	5	6	5
Të hollat e dërguara në para të gatshme nga Kosova	0	2	1
Neto të ardhurat nga biznesi vetanak në Kosovë	11	2	10
Para të gatshme të dërguara nga jashtë nga anëtarët aktual/prezent/(pagat,transferet, etj)	9	9	9
Para të gatshme të dërguara nga diaspora nga persona të tjerë	3	3	3
Të tjera	1	1	1
Të hyrat nga bujqësia	4	0	3
Totali në %	100	100	100
Totali në milion €	812 €	198 €	1.010 €

**Tabela 9: Burimet e të hyrave sipas nivelit më të lartë të arsimimit, viti 2007**

Burimi i të hyrave	Fillor	Mesëm	Universiteti ose më lartë
Neto rrogat dhe pagesat e fituara në Kosovë,neto pa tatim	29	61	82
Pagat në natyrë	1	0	0
Të ardhurat nga mëditjet	9	7	0
Qiraja, dividendat, interesi (nga kursimi në bankë)	2	2	3
Benefitet për mirëqenie sociale	4	2	0
Pensionet nga Kosova	5	1	1
Pensionet nga jashtë Kosovës	8	3	3
Të hollat e dërguara në para të gatshme nga Kosova	1	1	0
Neto të ardhurat nga biznesi vetanak në Kosovë	8	13	7
Para të gatshmet të dërguara nga jashtë nga anëtarët aktual/prezent/(pagat,transferet, etj)	18	6	1
Para të gatshme të dërguara nga diaspora nga persona të tjerë	7	2	1
Të tjera	1	1	0
Të hyrat nga bujqësia	7	2	1
	100	100	100

### 3.3. Pabarazia gjinore

Femrat kanë të hyra shumë më të ulëta se meshkujt, si grup dhe si mesatare individuale. Si shpjegim mund të jetë vëllimi i ndryshëm i punëve sesa pagat e padrejta.

**Tabela 11: Të hyrat mesatare nga punësimi 12 mujor sipas gjinisë, €**

Të hyrat	Meshkuj	Femra	Të gjithë
Rrogat për punësim 12 mujor	2.220 €	1.640 €	54%

Meshkujt fitojnë pothuajse 26 % më shumë se femrat brenda periudhës 12 mujore të punësimit.



## Enti i Statistikës së Kosovës përshkrim i shkurtër

**Enti i Statistikës së Kosovës**, është Ent profesional, vepron që nga viti 1948 dhe ka kaluar disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe. Më 2 Gusht 1999, Enti ka rifilluar punën profesionale, si i pavarur në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike. Enti financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe donatorë për projekte të veçanta.

**Enti i Statistikës së Kosovës** vepron sipas Rregullores 2001/14 e cila ka hyrë në fuqi me 2 Korrik 2001. Një Master Plan afatmesëm është duke u përgatitur për zhvillimin e sistemit statistikor kompatibil me Statistikat Evropiane.

**Struktura organizative e ESK-së**, katër *Departamente prodhuese* (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të popullsisë, Departamenti i statistikave sociale dhe Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe ambientit), *shtatë Zyra Rajonale* (Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë dhe Ferizaj), *dy Departamente mbështetëse* (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative dhe Departamenti i administratës), si dhe *Zyra e regjistrimit të popullsisë*, përbëjnë ndërtimin struktural të ESK-ës. Të punësuar janë gjithsej 134 punëtorë, prej tyre, 96 (71.6%) në seli të Entit, gjersa në Zyrat Rajonale, 38 (28.4%) .

Kemi mbështetje dhe bashkëpunim profesional me institucionet ndërkombëtare. Enti i Statistikës së Kosovës ka një terren krejtësisht të mbuluar në shkallë vendi. Për implementim e Anketave në terren përdorim mostrën dhe metodologjinë adekuate. Gjatë grumbullimit të raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale.

Një ekip i ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtar janë duke punuar në projektin e regjistrimit të popullsisë.

**Misioni i Entit**, është që të përmbush nevojat e përdoruesve me të dhëna statistikore objektive dhe analiza të rregullta në mënyrë që të përkrah departamentet qeveritare, t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa:** Enti i Statistikës së Kosovës, Rr."Zenel Salihu" Nr.4, Prishtinë
- **Telefonat:**  
**Qendra kryesore: +381 (0) 38 235 111**  
**Drejtori: +381 (0) 38 235 545**
- **Fax: +381 (0) 38 235 033**
- **E-mail:** [social@ks-gov.net](mailto:social@ks-gov.net)
- **Ueb-faqe:** [www.ks-gov.net/esk](http://www.ks-gov.net/esk)